

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore si dhe detyrat e kompetencat e organeve përgjegjëse për:

- vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e emërimit “Specialitet tradicional i garantuar”;
- verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet e produktit për kërkesat për regjistrim të emërtimeve të origjinës dhe të treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe ushqimore, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 178, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar;
- verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM, para vendosjes së tyre në treg;
- kryerjen e kontrolleve zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM me kërkesat e përcaktuara në këtë projektligj;
- vlerësimin e aplikimeve për skemat e tjera të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat nuk janë pjesë e tri skemave (STG, EOM, TGJM).

Projektligji do të zbatohet për produkte bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, që do të përcaktohen sipas listës që do të miratohet me urdhër të Ministrit.

Të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat ofrojnë karakteristika të veçanta tradicionale dhe vlerë të shtuar në mënyrën e prodhimit/përpunimit të tyre, do të regjistrohen si emërtime cilësie STG, EOM dhe TGJM ose skema të tjera cilësie.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin e Këshillit të Ministrave dhe politikat e ministrisë. Miratimi i këtij projektligji nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projekteve të Këshillit të Ministrave për

vitin 2018, por u paraqit duke qenë mjaft i rëndësishëm dhe detyrim i rekomandimeve të BE-së.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë kryesore të projektligjit lidhen me qëllimin:

- për të ndihmuar prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore të reklamojnë cilësinë e produkteve të tyre te konsumatorët;
- për të siguruar konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë;
- për të dhënë informacionin e nevojshëm për konsumatorin për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut;
- për të vlerësuar dhe regjistruar STG;
- për të kryer vlerësimin në substancë të EO-ve dhe TGJ-ve për produktet bujqësore dhe ushqimore;
- për të mundësuar hartimin dhe publikimin e regjistrit për STG-të dhe produktet, pjesë të skemave të tjera të cilësisë;
- për të rritur kërkesën në drejtim të cilësisë së produkteve tradicionale dhe shumëllojshmërisë së prodhimeve bujqësore;
- për të kontribuar dhe plotësuar politikat e përcaktuara në skemat e zhvillimit rural, bazuar në politikat e përbashkëta evropiane;
- për të nxitur zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe zonave malore.

Trajnimi dhe eksperiencia e specialistëve që do të merren me këtë proces përbën një sfidë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Efektet e pritshme të këtij projektligji lidhen me rritjen e nivelit të jetesës, zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale si dhe me shumëllojshmërinë e prodhimit bujqësor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë. Ky projektligj për afron pjesërisht rregulloren e BE-së, nr.1151/2012, “Për Skemat e Cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, si dhe plotëson detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, nenet: 176, 178, 182/c dhe 182/ç.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji për afron pjesërisht rregulloren (EU) nr.1151/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 nëntor 2012 për skemat e cilësisë për

produktet bujqësore dhe ushqimore, të ndryshuar. Numri CELEX: 32012R1151; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 343/1, datë 14.12.2012, faqe 1-23.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anën e këtij projektligji propozohet hartimi i një baze për vlerësimin dhe regjistrimin e STG-ve, për vlerësimin e EO-ve dhe TGJ-ve, si dhe vlerësimin dhe regjistrimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që nuk janë pjesë e tre skemave, por që plotësojnë kushtet që lidhen me karakterin specifik të prodhimit, traditës etj.

Projektligji përbëhet nga 11 krerë.

Kreu I – Dispozita të përgjithshme, përbëhet nga tri nene dhe argumenton qëllimin, fushën e zbatimit dhe përkufizimet për termat e përdorur në këtë projektligj.

Kreu II – Organet përgjegjëse për regjistrimin e STG-ve dhe vlerësimin e specifikimeve për EO-të dhe TGJ-të përbëhet nga dy nene dhe përcakton organet përgjegjëse dhe komisionin për skemat e cilësisë;

Kreu III – Emërtimi “Specialitet tradicional i garantuar (STG)”, përbëhet nga dy nene dhe përcakton kriteret e vlerësimit dhe të drejtën për të paraqitur një aplikim;

Kreu IV – Procedurat për regjistrimin e emërimit STG, përbëhet nga shtatë nene dhe përcakton paraqitjen dhe përbërjen e aplikimit, verifikimin e formaliteteve, njoftimin dhe publikimin, procedurën e kundërshtimit, vendimet e komisionit, ndryshimin e specifikimeve dhe tarifat;

Kreu V – Mbrojta kombëtare dhe logoja, përbëhet nga tri nene dhe përfshin: mbrojtjen kombëtare dhe qëllimin si dhe përdorimin dhe emërtimin e logos;

Kreu VI – Procedura në rast kundërshtimit të ndërsjellë të aplikimit në BE, përbëhet nga dy nene dhe përcakton kundërshtimin ndaj aplikimit të paraqitur nga një vend tjetër në BE dhe paraqitjen e aplikimit për regjistrim në BE nga Shqipëria;

Kreu VII – Vlerësimi i specifikimeve për EO-të dhe TGJ-të përbëhet nga dy nene dhe përcakton dorëzimin e aplikimeve për EO dhe TGJ në Komision dhe vendimin e tij;

Kreu VIII – Verifikimi i përputhshmërisë me specifikimet e produktit për STG, EOM, TGJM dhe kontrollet zyrtare, përbëhet nga tetë nene dhe përcakton dhe detajon në mënyrë të qartë autoritetet për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve me karakteristikat specifike, trupat e certifikimit, miratimin dhe auditimin e tyre, kontrollet zyrtare, raportimin, si dhe procedurat në rastin e parregullsive;

Kreu IX – Skema të tjera cilësie, përbëhet nga katër nene dhe përcakton kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë produktet bujqësore dhe ushqimore për të qenë pjesë e këtyre skemave. Disa nga këto skema mund të jenë: produktet tipike, produktet e zonave malore, etj. Përcaktohet edhe ngritja e një komiteti këshillimi për ministrin, për të vlerësuar dhe dhënë mendim për produktet

bujqësore dhe ushqimore dhe, gjithashtu, mbrojtja kombëtare dhe e drejta e përdorimit.

Kreu X – Kundërvajtjet administrative dhe masat, përbëhet nga dy nene dhe përcakton masat që parashikohen në rast të shkeljeve në zbatimin e këtij ligji, si dhe të drejtën për ankim.

Kreu XI – Dispozitat e fundit, përbëhet nga tri nene dhe parashikon nxjerrjen e akteve ligjore në zbatim dhe shfuqizimet e disa akteve të tjera ligjore si dhe hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon efekte financiare, të cilat do të përcaktohen më mirë me aktet nënligjore përkatëse, të përcaktuara në nenin 36, të projektligjit, duke specifikuar dhe organet/institucionet përgjegjëse për këto akte. Do të propozohen edhe ndryshimet përkatëse në vendimin nr.656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural këto efekte do t’i përballojë nga buxheti i akorduar, pa kosto financiare shtesë.

Është llogaritur që shpenzimet e mundshme të jenë, afërsisht, 3.1 milionë lekë/vit, ndërkohë që të ardhurat të arrijnë dyfishin e tyre.

Bashkëlidhur është edhe tabela e parashikimit financiar.

KËSHILLI I MINISTRAVE